



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i ekspertit Shqyrtues dhe nënshkrimi Faruk Rexha	Data e autorizimit të ekspertit 11.01.2023	Data e dorëzimit të raportit 18.01.2023	Nr. i lëndës: 16/23
---	---	---	----------------------------

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.01.2023, Grup i Operatorëve Ekonomik: “INVEST PRO” SH.P.K. & “Trasing Group” Sh.p.k. Fushe Kosovë, ka parashtruar ankesë me nr: 16/23, ndaj njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV” -Prishtinë- me nr. të prokurimit: 204-22-10111-5-1-1 dhe nr. të brendshëm: MINT 204-22-058-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Punë.
Vlera e parashikuar është: 726 895,80 €.

Kriteri dhënies së kontratës: Tenderi i përgjegjshme me çmim me të ulet.

- Data njoftimi për kontratë: 04.10.2022
- Afati për dorëzimin e ofertave: 18.10.2022
- Procesverbali i hapjes së ofertave: 18.10.2022
- Raporti i Vlerësimit : 20.12.2022
- Njoftimi mbi Vendimin e AK-se dhe Letrat Standarde 22.12.2022
- Kërkesa për Rishqyrtim: 27.12.2022
- Vendimi për refuzim i autoritetit kontraktues i kërkesës për rishqyrtim 28.12.2022

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE: “INVEST PRO” SH.P.K. & “Trasing Group” Sh.p.k. Fushe Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV” -Prishtinë- me nr. të prokurimit: 204-22-10111-5-1-1 dhe nr. Te brendshëm: MINT204-22-058-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Eliminim nga procedurat e prokurimit ne kundërshtim me LPP-në.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Të nderuar ju njoftojmë se me datë 22.12.2022 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është shpallur situatë OE “Pro & Co Group SHPK” ndërsa neve jemi eliminuar, me arsyetimin se :

Ju keni ofruar letër mbështetje nga banka BKT mirëpo këtij dokumenti të bankës i mungojnë edhe disa të dhëna të rëndësishme si numri i protokollit të lëshuar nga kjo bankë sipas rregullave si dokument zyrtar i bankës, i mungon emri dhe mbiemri i zyrtarit që e ka aprovuar këtë dokument apo emri dhe mbiemri i menaxherit në pikën e lëshuar Skenderaj”.

Fillingisht ju sqarojmë se ky arsyetim nuk qëndron dhe nuk është i bazuar në fakte konkrete dhe dëshmitë e ofruara nga ne si OE.

Ne ju konfirmojmë se dokumenti i lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare me datën 14.10.2022 lidhur me mbështetjen bankare është dokument origjinal, e cila mban vulën origjinale të bankës së lartcekur dhe nënshkrimin zyrtar.

Për më tepër, ju sqarojmë se kërkesë në dosje të tenderit tek neni 8.1 & 8.2 i FDT-së ka qenë I. Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës ose akses në kredi nga banka në vlerë prej së paku 100,000.00€, kurse dëshmi e kërkuar dokumentare ka qenë : Dëshmia -- 1 Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt.

Pra, nëse bazohemi në kërkesë dhe në dëshminë e kërkuar dokumentare vërehet qartë se dokumenti nga banka nuk është kërkuar që të ketë ndonjë të dhënë tjetër specifike, përveç se i nënshkruar dhe vulosur lidhur me këtë projekt.

Edhe dokumenti që ne kemi bashkangjitur me ofertë ka qenë i nënshkruar dhe vulosur lidhur me këtë projekt, prandaj rezulton se dëshmia nga banka ka qenë pikërisht konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Me këtë veprim, autoriteti kontraktues ka rënë ndesh me dispozitën e nenit 56.3 të LPP-së sepse na ka eliminuar për një kërkesë që nuk ka qenë në dosje të tenderit dhe të njoftimit për kontratë (nuk është kërkuar që të figuron emri i personit që nënshkruan e as numër i referencës).

Pra autoriteti kontraktues ka mundur të shfrytëzojë dispozitën e nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së që të kërkojë sqarime eventuale nga Banka, nëse më të vërtetë ka pasur ndonjë dilemë me dokumentin e lëshuar nga Banka, e jo të na eliminojë neve pa ndonjë sqarim (edhe pse dëshmia nga Banka ka qenë konform kërkesës së FDT). Po ashtu ka mundur të kërkojë sqarime shtesë edhe nga ne si operator ekonomik ofertues dhe njëkohësisht më çmim më të lirë se sa OF i rekomanduar për kontratë.

Në konfirmimin e lëshuar nga Banka janë të specifikuara gjitha shënimet se nga kush është lëshuar dokumenti i datës 14.10.2022.

Pra duke pasur parasysh faktet dhe dëshmitë e ofruar nga ne si OE, i përgjegjshëm dhe më ofertën me çmimin më të lirë në krahasim me OE të rekomanduar për kontratë, dëshmohet se arsyeja e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit është e pa bazuar dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së dhe me kërkesat e FDT-së.

1. Pils iestādē ir jānodrošina, lai katrā kārtošanas telpā būtu pietiekami daudz vietu, lai ievietotu visus iedzīvotājus, kas ir pakļauti šīs telpas izmantošanai.
2. Pils iestādē ir jānodrošina, lai katrā kārtošanas telpā būtu pietiekami daudz vietu, lai ievietotu visus iedzīvotājus, kas ir pakļauti šīs telpas izmantošanai.
3. Pils iestādē ir jānodrošina, lai katrā kārtošanas telpā būtu pietiekami daudz vietu, lai ievietotu visus iedzīvotājus, kas ir pakļauti šīs telpas izmantošanai.

AK-ja e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim duke u arsyetuar si në vijim:

"Sigurimi i informacionit qe mundon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenciale e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.

Atbi bazën e kësaj ju ne kërkesën për Rishqyrtim kemi ofruar dokumentin e bankës jo ne përputhet me legjislacionin ne juqi sepse data e ofrimit te këtij dokument është jo vetëm se para hapjes se ofertave por edhe pas përmbylljes se procesit qe ka rezultuar me njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues pra me date 22.12.2022 ndërsa ju me këtë dokument jeni pajisur pas pranimit te njoftimit si tenderues i eliminuar pra me date 23.12.2022 qe me këtë rast është krijuar një dokument i ri edhe ne datën e dokumentit por edhe ne numrin e protokollit pas mbylljes se procesit . gjithashtu me këtë rast ju vetëm se po e pranoi se një dokument te tille zyrtar nuk e keni ofruar ashtu siç është kërkuar”

Ky konstatim i AK-së është i pa saktë dhe i pa qëndrueshëm, për më tepër tendencioz sepse nuk pasqyron realitetin në lidhje me këtë lëndë.

Sa për rikujtim, ne kemi ofertuar me dëshmi të Bankës ashtu siç ka qenë kërkesa e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë, pra dëshmia nga Banka është ofruar 100% konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe normalisht nuk ka pasur nevojë të kërkohej sqarime shtesë fare në lidhje me këtë dokument. Pra në momentin që na keni eliminuar, ju keni vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.

Pas pranimit të letres standarde për tenderues të eliminuar, ne kemi kërkuar një sqarim nga Banka në lidhje me dokumentin që e kishte lëshuar banka dhe të cilin ne e kishim bashkangjitur në ofertë. Sa për korrektësi, ne nuk kemi kërkuar dokument të ri, por kemi kërkuar sqarim, kurse Banka ka lëshuar vërtetimin sqarues me dt.23.12.2022 në lidhje me dokumentin e Bankës të lëshuar me dt.14.10.2022. Pra vërtetimi i dt.23.12.2022 e sqaron dhe e konfirmon origjinalitetin dhe saktësinë e dokumentit të lëshuar me dt.14.10.2022 dhe ky sqarim normalisht që lëshohet me datën kur bëhet sqarimi, por sqarimi është bërë për një dokument i cili ishte lëshuar para datës së ofertimit dhe ky sqarim nuk përbën ndryshim material por është konfirmim mbi origjinalitetin e dokumentit i cili ishte dorëzuar me ofertë.

Po ashtu, arsyetimi se këtu kemi të bëjmë me dokument të ri dhe se nuk vihet në zbatim Neni 72 i LPP-së, është i pa qëndrueshëm, sepse ne kemi ofruar vërtetim sqarues në lidhje me dokumentin të cilin AK-ja fillimisht e ka konsideruar si dokument jo valid, prandaj ne nuk kemi ofruar asnjë dokument të ri, mirëpo kemi ofruar vërtetim sqarues për ta konfirmuar dokumentin zyrtar të cilin e ka lëshuar banka. Dhe e gjithë kjo ka ardhur si pasojë që AK-ja nuk i është përmbajtur dispozitave ligjore të LPP-së, fillimisht nenit 56.3 dhe më pastaj Nenit 72 paragrafi 2 “Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në paktim me nenet 65-71 të këtij ligji”.

Autoriteti kontraktues ndër të tjera në vendimin për refuzim e ka cekur se “për korrektësinë e procedurës edhe pse ju keni ofruar dokumentin e datës 23.12.2022 nga banka në brendësi të tij keni kundërtëthënien e kjarë se pse këtij thuhet që Letër mbështetja është nënshkruar nga Analisti i Bizneseve Berat Duraku si person përgjegjës, ndërsa në dokumentin e bankës që ju keni prezantuar në oferte askund nuk përmendet emri dhe mbiemri i tij por gjithashtu ai dokument nuk ka as datë të protokollimit si dokument ushtu siç kjo bankë i ka rregullat e brendshme që iu referohet dispozitave ligjore të Bankës Qendror të Kosovës. Si krahasim të këtij dokumenti kemi marrë ofertat e OE të tjerë pjesëmarrës në të njëjtën procedurë për të njëjtën bankë dhe shifet kjarë se dallojnë këto dokumente pra nuk janë të formatit njëjtë për nga mënyra e lëshimit të dokumentit dhe se nuk mund që banka e njëjtë të ketë standarde të ndryshme për OE të ndryshëm për dokumentin e njëjtë”.

Ky arsyetim i AK-së është i pa qëndrueshëm, jo profesional dhe shumë subjektiv duke tentuar që të zhvlefësojë edhe vërtetimin sqarues të Bankës. Vetë Banka e ka sqaruar se kush e kishte lëshuar dokumentin e dt.14.10.2022, i cili dokument e ka përmbajtur nënshkrimin, prandaj përderisa ka qenë nënshkrimi i një personi zyrtar, Banka në këtë rast ka bërë sqarim se kush e ka nënshkruar këtë dokument dhe në këtë rast autoriteti kontraktues merret me çështje jo esenciale dhe nuk merret me përmbajtjen e dëshmisë nga Banka dhe me faktin se a plotësohet kërkesa me dëshminë bankare apo jo. Në këtë rast, vetë autoriteti kontraktues merr përgjegjësi në shumë se sa vetë personat zyrtar të Bankës, madje konteston dokumentet të cilat i ka lëshuar banka e që përsëri i konfirmojnë të njëjtat. Ky arsyetim i AK-së, nuk ka se si të kuptohet ndryshe përveç se tendencë e pastër ndaj kompanisë tonë dhe favorizim i hapur i kompanisë fituese.

Pavarësisht të gjitha tendencave dhe përpjekjeve për të na eliminuar nga konkurrenca, edhe njëherë e sqarojmë se në këtë rast, as nuk ka pasur nevojë për sqarime shitesë dhe as nuk kemi mundur të eliminohemi nga konkurrenca, sepse kërkesa e FDI-së ka qenë që dëshmia nga Banka të jetë e nënshkruar dhe e vëltosur, dhe nuk ka qenë e specifikuar se duhet të figurojë emri i personit që ë nënshkruan, e as numri i referencës, prandaj ne jemi eliminuar pa të drejtë në këtë procedurë të prokurimit.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Në në këtë procedurë kemi ofertuar me çmim prej 633,358.58 euro, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 688,835.12 euro. Pra në këtë rast autoriteti kontraktues rrezikon ta dëmton buxhetin në vlerë prej 55,476.54 euro, pa asnjë arsye të vetme. Veprimi i autoritetit kontraktues bën ndeshje dhe me nenin 6 të LPP-së, pasi që dihet që kjo dispozitë parashihet që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike

Gjithashtu AK nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne jemi OE më i lirë dhe gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parashih qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu AK nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të marr:

APROVOHET, si e bazuar ankesa e Grupi i Operatoreve Ekonomik: **OE INVEST PRO SH.P.K. & TRADING GROUP SH.P.K.**

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së, si dhe lënda kthehet në

RIVLERËSIM,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L – 042 , Neni 65, siç është e cekur në Pjesën, do të dorëzohen në formë të Aneksit. 2. Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nënadministrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore- kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar jo më e vjetër se 30 ditë, (mos dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të diskualifikoj tenderin tuaj, por duhet dorëzohet nga OE te cilit synohet dhënia e kontratës). 3 . Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit, (mos dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të diskualifikoj tenderin tuaj, por duhet dorëzohet nga OE te cilit synohet dhënia e kontratës), 1. Deklarata nën betim-kërkohet origjinal 2. Vërtetimi nga Gjykata Themelore – kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar noterizuar. 3. Vërtetimi nga ATK - kërkohet origjinal apo kopje.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE: "INVEST PRO" SH.P.K. & "Trading Group" Sh.p.k. Fushe Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV" -Prishtinë- me nr. të prokurimit: 204-22-10111-5-1-1 dhe nr. Te brendshëm: MINT204-22-058-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

1. Një deklaratë e nënshkruar nga autoriteti i përshtatshëm publik në vendin tuaj të themelimit të regjistrimit tuaj në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës, duhet të dorëzohet, së bashku me përshkrimin e veprimtarive primare dhe sekondare të kompanisë ku edhe përfshihen natyra e ngjashme 2. Certifikata e TVSH-së 3. Certifikatën e Numrit Fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Kopje e certifikatës së biznesit. 2. Certifikata e TVSH-së-(kopje). 3. Certifikata e Numrit Fiskal (kopje).

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës ose akses në kredi nga banka në vlerë prej së paku 100,000.00€, 2.Qarkullimi mbi gjendjen financiare gjatë 3-tri viteve të fundit të jetë me se paku 1,400,000.00€, Dëshmia – 1. Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt. Dëshmia -2 Raportet mbi gjendjen financiare tri vitet e fundit të audituara nga një kompani e licencuar e auditimit ose auditor i licencuar te prezantohet kopja e noterizuar e licencës së auditorit kompanisë audituese. a)Deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tre (3) vitet fundit

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori Ekonomik duhet ofroj listën e kontratave per gjate 3-tri viteve prej datës se njoftimit per kontarte do të jete vlera prej se paku 1,000,000.00 euro që ka ndërtuar realizuar projekte kapitale, që në vehte përmbajnë ujësjellës, kanalizime, rrugë, elektrikë, etj, dhe të përcjelluar me referenca për kontratat e njëjta.
2. Kompania ekzekutuese ndërtuese duhet të ketë 2.1.Një Ing. dip. Konstruktiv, 2.2.Një Ing. dip. Hidroteknik, 2.3.Një Ing. dip. Elektro, 2.4.Një Ing. dip. Gjeodezi, 2.5.Një Ing. dip. i Infrastrukturës,
3. Të emëroj me vendim një menaxher të projektit dhe të bashkëngjis diplomën e menaxherit, CV dhe kontratën marrëveshjen për realizim të këtij projekti.
4. Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për Siguri dhe shëndet në punë. (në rast konzorciumi atëherë duhet të jenë të pajisur secili anëtar i konzorciumit veç e veç për shkak të natyrës së rrezikshmërisë së punës).
5. Lista e stafit mbështetës të angazhuar në projekt ; Një listë prej së paku Minimum 20 punëtor.
6. Kërkesa.Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit Operatori ekonomik së paku duhet të paraqes listën e pajisjeve për 3-kamiona me peshë bartëse 10 e më shumë m3, 1-eskavator mbi 20 tona 1-eskavator 5-7 tona 1-skipë, 3-bagera, 1-grejder, 2-valaka
7. OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes per zhavor.
8. OE duhet të ketë bazë për prodhimin e betonit

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE: "INVEST PRO" SH.P.K. & "Trasing Group" Sh.p.k. Fushe Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV" -Prishtinë- me nr. të prokurimit: 204-22-10111-5-1-1 dhe nr. Te brendshëm: MINT204-22-058-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Dëshmia-1 Lista kontratave duhet të jete origjinal e vulosur dhe nënshkruar prej kompanisë si dhe kopja e referencave për kontratat e njëjta.
2. Dëshmia-2 Diplomë universitare-kopje, Përvoja e punës së paku dy vite përvojë pune për inxhinierët me fakultet pesëvjeçar, derisa së paku katër vite përvojë pune për ata me sistem bachelor. Përvoja e dëshmuar me CV (të nënshkruar) dhe kontratë-kopje, apo me CV (të nënshkruar) dhe letër referencë-kopje. Kompania duhet të ofroj dëshmi për stafin e lartë cekur që ka kontratë të rregullt të punës ose marrëveshje paraprake me stafin për realizimin e projektit në fjalë.
3. Dëshmia-3 Vendimi i kompanisë Origjinal dhe sipas kërkesës.
4. Dëshmia-4 Dëshmia Kopja e raportit të vlerësimit të riskut në vendet e punës, kopja licencës së kompanisë së licencuar për ushtrimin e punëve nga siguria dhe shëndeti në punë.
5. Dëshmia-5 Dëshmia Lista e punëtorëve e vulosur dhe nënshkruar dhe te dëshmuar me ATK,
6. Dëshmia-6 Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet të ketë në emër të kompanisë dhe të dëshmohet me kopje të librezave ose të ketë të kontraktuar (me qira) dhe të dëshmohet me kontratë marrëveshje për shfrytëzim dhe me kopje të librezave.
7. Dëshmia-7 Dëshmia Për gurëthyesin duhet të silltet licenca për aktivitete te veçanta e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim te noterizuar ne emër te projektit.
8. Dëshmia-8 Dëshmia Për bazën e betonit duhet të silltet dëshmia Licenca e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Ne rast se OE nuk posedon bazën e prodhimit, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim te noterizuar ne emër te projektit.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR GJENDJEN EKONOMIKE & FINANCIARE

Dokumenti	Grup i Operatorëve Ekonomik B FAMIS SH.P.K. - Bujar Shabanaj B.I	Grup i Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I, N.N.SH WORLD MEDIUM	Pro & Co Group SH.P.K	Bentla Company	Grup i Operatorëve Ekonomik INVEST PRO SH.P.K. Trasing Group Sh.p.k
	Në pajtun Nuk është në pajtun	Në pajtun Nuk është në pajtun	Në pajtun Nuk është në pajtun	Në pajtun Nuk është në pajtun	Në pajtun Nuk është në pajtun
1 Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës ose akces në kredi nga banka në vlerë prej së paku 100,000.00€ 2 Qarkullimi i mbij gjendjen financiare gjatë 3- in viteve të fundit të jete me se paku 1,400,000.00€.	Në pajtun	I papajtueshëm	Në pajtun	Në pajtun	I papajtueshëm

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare:

Në këtë fazë OE Grup i Operatorëve Ekonomik B FAMIS SH.P.K.; Bujar Shabanaj B.I, Pro & Co Group SH.P.K. dhe Bentla Company kanë sjellur dokumentacionin sipas afishimit për kontratë dhe dosje të tenderit ndërsa OE Grup i Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I.; N.N.SH, WORLD MEDIUM këtë dokument e ka të arsyshur për një institucion tjetër, kurse OE Grup i Operatorëve Ekonomik INVEST PRO SH.P.K.; Trasing Group Sh.p.k.Dokumentin e lëshuar nga banka për akses në kredi sipas rregullave nuk posedon numër të protokollit të bankës, i mungojnë enurat dhe nënshkrimi i personave përgjegjës të pikës në Shëndëraj.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE: "INVEST PRO" SH.P.K. & "Trasing Group" Sh.p.k. Fushe Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qyrlagë – Faza e IV" -Prishtinë- me nr. të prokurimit: 204-22-10111-5-1-1 dhe nr. Te brendshëm: MINT204-22-058-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E AFTËSIVE PROFESIONALE TË TENDERËVE

Dokumenti	Grup i Operatorëve Ekonomik B FAMIS SH.P.K.; Bujar Shabani B.I.	Grup i Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I., N.N.SH WORLD MEDIUM	Pro & Co Group SH.P.K.	Benita Company	Grup i Operatorëve Ekonomik INVEST PRO SH.P.K. Trasing Group Sh.p.k
	Në pajtim Nuk është në pajtim	Në pajtim Nuk është në pajtim	Në pajtim Nuk është në pajtim	Në pajtim Nuk është në pajtim	Në pajtim Nuk është në pajtim
1. Operatori Ekonomik duhet ofroj listen e kontratave për gjatë 3-tri viteve prej datës së njoftimit për kontratë do të jete vlera prej së paku 1.000,000 00 euro që ka ndërtuar realizuar projekte kapitale, që në veltë përmbajnë ujësjellës, kanalizime, rrugë, elektricitet, etj, dhe të përcjelluar me referenca për kontratat e njëjta.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
2. Kompania ekzekutuese ndërtuese duhet të ketë 2.1. Një Ing. dip. Konstruktiv, 2.2. Një Ing. dip. Hidroteknik, 2.3. Një Ing. dip. Elektro, 2.4. Një Ing. dip. Gjeodezi, 2.5. Një Ing. dip. i Infrastrukturës, 3. Të emëroj me vendim një menaxher të projektit dhe të bashkëngjis diplomën e rregullshërimit, CV dhe kontratën marrëveshjen për realizim të këtij projekti.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
4. Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për Siguri dhe shëndet në punë. (në rast konzorciumi atëherë duhet të jenë të paisur secili antar i konzorciumit veç e veç për shkak të natyrës së rrezikshmërisë së punës)	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	I papajtueshëm	Në pajtim
5. Lista e stafit mbështetës të angazhuar në projekt ; Një listë prej së paku Minimum 20 puntorë gjatë tri viteve të fundit	I papajtueshëm	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
6. Kërkesa. Operatori Ekonomik duhet të posedojë ajetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshura për realizimin e projektit Operatori ekonomik së paku duhet të paraqes listën e pajisjeve për 3- kamionat me peshë bariere 10 e më shumë m3, 1- eskavator mbi 20 tona 1- eskavator 5-7 tona 1- skipë, 3- bagera, 1- grejder, 2- valanka	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
7. OE duhet të jete i licencuar si gurëthyes për zhavor.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	I papajtueshëm	Në pajtim
8. OE duhet të ketë bazë për prodhimin e betonit	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

OE Grup i Operatorëve Ekonomik B FAMIS SH.P.K.; Bujar Shabani B.I., Grup i Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I.; N.N.SH. WORLD MEDIUM, Pro & Co Group SH.P.K., Benita Company dhe Grup i Operatorëve Ekonomik INVEST PRO SH.P.K.; Trasing Group Sh.p.k. kanë sjellur dokumentacionin për listen e kontratave së bashke me qarkullimet, kanë sjellur edhe dëshmitë e stafit profesional, listen e pajisjeve e dhe licencat e për bazën e prodhimit të betonit, adresa OE Grup i Operatorëve Ekonomik B FAMIS SH.P.K.; Bujar Shabani B.I. nuk ka sjellur listen e stafit mbështetës, OE Benita company nuk ka sjellur licencën e kompanisë për vlerësimin e riskut poashtu edhe pas kërkesës për sqarime shitesë OE Benita Company nuk ka sjellur marrëveshjen e noterizuar për bazën e prodhimit të zhavorit

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

NUK KA

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

Operatori ekonomik është palë me interes në këtë procedurë të prokurimit

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE: "INVEST PRO" SH.P.K. & "Trasing Group" Sh.p.k. Fushe Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV" -Prishtinë- me nr. të prokurimit: 204-22-10111-5-1-1 dhe nr. Te brendshëm: MINT204-22-058-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Lidhur me këtë rast nuk ka pas ndonjë shqyrtim me herët, ne përjashtim te kërkesës për rishqyrtim nga ana e autoritetit kontraktues.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

Nuk shoh ndonjë devijim

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "INVEST PRO" SH.P.K. & "Trasing Group" Sh.p.k.

Përgjigjeje ne pretendimet ankimore

Pretendimet ankimore

1. Sheklje neni 1 i LPP-së.
2. Skelje neni 6 i LPP-së
3. Skelje neni 7 i LPP-së
4. Skelje neni 59 i LPP-së
5. Skelje neni 72 i LPP-së

Pas analizimit te pretendimeve ankimore, shkresave te lëndës, dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë, te përgatitur nga autoriteti kontraktues, konstatohet se te gjitha pretendimet ankimore janë te bazuara.

Arsyetim:

Autoriteti kontraktues e dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë konkretisht piken 1 ka paraparë kriterin si vijon:

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës ose akses në kredi nga banka në vlerë prej së paku 100,000.00€

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia – 1 Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt.

Operatori ekonomik ankues ne këtë rast, ka përmbushur këtë kriter duke ofruar dëshmi nga banka te nënshkruar dhe vulosur.

Dokumenti është dorëzuar ne origjinal, ku ka te përfshirë llogon e bankës, nënshkrimin e personit të autorizuar dhe vulën e institucionit bankar dhe emrin e projektit.

Për me tepër edhe pse nuk ka qenë e nevojshme fare konfirmimi nga banka i njëjti është rikonfirmuar nga ana e operatorit ekonomik ankues.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues në këtë rast se dokumenti i lëshuar nga banka nuk plotëson kriteret e parapara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është i paqëndrueshëm, sepse siç u specifikua edhe me lartë është kërkuar dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar dhe nuk ka paraparë fare ato në çka është thirrur autoriteti kontraktues për eliminimin nga kjo procedurë e prokurimit të operatorit ekonomik në fjalë.

Sa për sqarimin tuaj edhe arsyetimi në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm, sepse ka fare pak rëndësi nëse është bërë sqarimi nga ana e operatorit ekonomik ankues apo autoritetit kontraktues për dokumentin në fjalë apo ngarkimi në platformën e-prokurimit, sepse ky kriter është plotësuar në tërësi nga ana e operatorit ekonomik qysh në fazën e dorëzimit të tenderit, për me tepër nëse ka pas dyshime lidhur me këtë dokument, autoriteti kontraktues ka pas mundësinë që ta sqarojë përmes sqarimeve shtesë ashtu siç parashihet me LPP konkretisht nën 59 pikë 2 dhe nën 72 ku thotë se:

Neni 59, pikë 2

Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Neni 72

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Edhe pse siç e sqarova edhe me lartë dokumenti ka përmbushur në tërësi kriterin e paraparë në dosjen e tenderit dhe sipas mendimit tim fare nuk ka qenë e nevojshme të kërkojen sqarime shtesë nga ana e autoritetit kontraktues, por e theksoj edhe njëherë nëse ka pas dyshime lidhur me lëshimin e dokumentit në fjalë, atëherë autoriteti kontraktues ka mundur të shfrytëzojë nenet e lartshënuar të LPP-së që të bëjë sqarimet e nevojshme.

Bazuar në sqarimet e mësipërme dhe pas analizimit të pretendimeve ankimore, shkresave të lëndës, dosjes së tenderit të përgatitur nga autoriteti kontraktues, **Pretendimet ankimore merren si të bazuara**, me këtë rast rekomandojmë panelin shqyrtues që këtë aktivitet të prokurimit, ta kthejë në **RIVLERËSIM**.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si e **BAZUAR**,
- Të **Anullohet** njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 22.12.2022
- Aktiviteti i prokurimit të kthehet në **RIVLERËSIM**

Raporti i ekspertizës të dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues: – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- Panelit Shqyrtues: – OSHP
- OE ankues: – “INVEST PRO” SH.P.K. & “Trasing Group” Sh.p.k. Fushë Kosovë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE: “INVEST PRO” SH.P.K. & “Trasing Group” Sh.p.k. Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qyragë – Faza e IV” -Prishtinë- me nr. të prokurimit: 204-22-10111-5-1-1 dhe nr. Te brendshëm: MINT204-22-058-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.